LIGJ
Nr.9930, datë 9.6.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9734, DATË 14.5.2007 "PËR TURIZMIN"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 5 e 8 shfuqizohen.

2. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"12. "Njësi akomoduese" është struktura, në pronësi apo përdorim të personave fizikë ose juridikë, të cilët vënë në dispozicion të klientëve vendas dhe të huaj, individë apo të organizuar në grupe, shërbimet e fjetjes, të ushqimit, pijes, si dhe lehtësitë e duhura, në objekte komode, kushte të mira pritjeje, nga një staf i kualifikuar, për një kohë qëndrimi të papërcaktuar.

Në një njësi akomoduese përfshihen:

a) "Hotel", një ndërtesë ose një grup ndërtesash, të pavarura nga ndonjë vendndodhje ndërtimi tjetër, me jo më pak se 6 dhoma, brenda një parcele të vetme toke, ku akomodimi, shërbimet shtesë dhe komoditeti ofrohen për publikun nga një staf i kualifikuar.

b) "Fshat turistik", struktura komplekse akomoduese, ku ndërtesat nuk e kalojnë lartësinë e tri kateve, me vendndodhje në zona turistike, brenda një parcele të vetme toke dhe të përcaktuar, që ofron, në mënyrë të përqendruar, gamën më të plotë të shërbimeve akomoduese turistike, shërbimet e veprimtarive sportive, argëtuese dhe çlodhëse, nga një staf i kualifikuar.

c) "Kompleks turistik", një kompleks ndërtesash, të grupuara, si apartamente, vila, studio, ndërtesa të vogla me dy kate, që ofron për klientët akomodim, cilësi, shërbime ndihmëse, vetëshërbim, nga një staf i kualifikuar.

ç) "Shtëpi pushimi", ka të njëjtin kuptim si hoteli, në lidhje me vendndodhjen, por, në terma më specifikë, janë ndërtesa ose një pjesë ndërtese me hyrje të veçantë, që menaxhohen dhe operohen nga një staf i kualifikuar dhe që ofron për klientët standardet bazë të akomodimit, shërbimeve ndihmëse dhe cilësisë. Dhoma mund të ndahet nga klientët.

d) "Bujtinë", ka të njëjtin kuptim si hoteli, në lidhje me vendndodhjen, por, në terma më specifikë, janë ndërtesa ose një pjesë ndërtese me hyrje të veçantë, që menaxhohet dhe operohet nga një staf i kualifikuar, me dhoma me komoditet, për përdorim nga klientët, me ndryshimin se elementet sanitare janë parashikuar të jenë në raporte të tilla: së paku një tualet dhe dush për çdo dhjetë persona ose një tualet dhe dush për një kat.".

3. Pika 20 ndryshohet si më poshtë:

"20. "Paketë turistike" është një kombinim i parapërgatitur shërbimesh, që shitet ose ofrohet për shitje dhe mbulon një periudhë për më shumë se 24 orë ose përfshin një natë akomodim. Ajo përbëhet nga jo më pak se dy prej shërbimeve të mëposhtme:

- transport;
- akomodim;
- shërbime të tjera turistike, të pavarura nga transporti dhe akomodimi dhe që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të paketës, që do të përfshihen në këtë kombinim të parapërgatitur

dhe kur këta komponentë janë faturuar si zëra të veçantë.”.

4. Pika 22 ndryshohet si më poshtë:

“22. “Restorant” është një sipërmarrje e furnizimit me ushqimin e lejueshëm për publikun, ku qëllimi kryesor është shitja e ushqimit për konsum, jashtë ose brenda lokalit (mjedisi), me shërbim në tryezë ose banak, në përputhje me standarde të përcaktuara.”.

5. Pika 24 ndryshohet si më poshtë:

“24. “Sipërmarrje turistike” është veprimtaria turistike, që ushtrohet nga persona fizikë apo juridikë, të tilla si: hotel, fshat turistik, kompleks turistik, njësi të tjera akomoduese, agjenci udhëtimi, operator turistik, agjenci në terren, transport të turistëve, prodhim ose shitje me pakicë të suvenireve apo punimeve artizanale, pika të tërheqjes së vizitorëve, sporte ujore ose ndonjë biznes tjetër.”.

6. Në pikën 37, fjalia e fundit shfuqizohet.

7. Pika 40 ndryshohet si më poshtë:

“40. “Kërkesë për zhvillimin e një sipërmarrjeje turistike” është kërkesa që bëhet përpara autoritetit të planifikimit, për të marrë leje zhvillimi për një ndërtim të ri apo ndryshim të rëndësishëm, si hotel, fshat turistik, kompleks turistik dhe njësi të tjera akomoduese.”.

Neni 2

Në nenin 11, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Komisioni i Standardeve të Turizmit, në vazhdim KST, është struktura që shqyrton kërkesat për zhvillimin e sipërmarrjeve turistike dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për turizmin.”.

Neni 3

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Përcaktimi i zonave të zhvillimit të turizmit

1. Përcaktimi i zonave të zhvillimit të turizmit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Zhvillimi i zonave, vendeve dhe pikave turistike bëhet në bazë të masterplanit kombëtar të zhvillimit të turizmit, të regjistrit të burimeve turistike dhe planifikimit të zhvillimit ekonomiko-social të tyre.”.

Neni 4

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

Procedura për përcaktimin e zhvillimit të sipërmarrjeve turistike dhe lehtësitë e përfitimit të asistencës financiare

1. Kërkesa për zhvillimin e një sipërmarrjeje turistike, si hotel, fshat turistik, kompleks turistik dhe njësi akomoduese, pas miratimit nga organet e qeverisjes vendore dhe përpara se të merret miratimi përfundimtar nga organi kompetent, sipas dispozitave ligjore në fuqi, duhet të marrë miratimin e ministrit përgjegjës për turizmin, në përputhje me kriteret e vendosura për këtë qëllim.

2. Kriteret dhe procedurat për zhvillimin e sipërmarrjeve turistike, si hotel, fshat turistik,

kompleks turistik dhe njësi të tjera akomoduese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Përfitimi i lehtësive dhe i asistencës financiare për një sipërmarrje turistike, si hotel, fshat turistik, kompleks turistik dhe njësi të tjera akomoduese, bëhet në përputhje me përcaktimet e nenit 26 të këtij ligji, si dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore.".

Neni 5

Në nenin 25 pika 2, shkronja "a" shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 27, në fund të pikës 2 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Subjekti, të cilit i është ndërprerë asistenca financiare me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, është i detyruar të kthejë të gjithë shumën e përfituar, së bashku me interesat.".

Neni 7

Neni 28 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 29 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 30, pika 2 shfuqizohet.

Neni 10

Pas nenit 30 shtohen nenet 30/1 dhe 30/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 30/1

Ndalimi i shitjes së njësive të veçanta akomoduese

Personat fizikë apo juridikë, që kanë marrë miratimin e ministrit përgjegjës për turizmin për zhvillimin e hoteleve, fshatrave turistikë, kompleksеve turistike dhe njësive të tjera akomoduese, në truall publik, sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", nuk lejohen të shesin njësi të veçanta të tyre.

Neni 30/2

Kushtet e transferimit të objektit të veprimtarisë

1. Edhe në rast të transferimit të titullit të objektit të veprimtarisë për zhvillimin dhe administrimin e hoteleve, fshatrave turistikë, kompleksеve turistike dhe njësive të tjera akomoduese, në truall publik, sipas dispozitave të Kodit Civil, subjekti përfitues nuk lejohet të ndryshojë destinacionin turistik apo të shesë njësi të veçanta të tyre.

2. Titullari përfitues duhet të plotësojë të njëjtat kritere si transferuesi paraardhës dhe duhet të marrë miratimin përkatës pranë ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Në rast se nuk zbatohen neni 30/1 dhe pikat 1 dhe 2 të këtij neni, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk bën regjistrimin e pasurisë.".

Neni 11

Në nenin 32, në fund të pikës 1 fjalët “sipërmarrje turistike” zëvendësohen me fjalët “sipërmarrje të tjera turistike”.

Neni 12

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Shoqëruesi i udhëtimit

Çdo agjent/agjenci udhëtimi apo operator turistik, që ka punësuar një shoqërues udhëtimi, duhet të lidhë kontratë, sipas ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Neni 13

Në nenin 42 pika 2, fjalët “për t’u licencuar si guidë, në përputhje me fushën dhe profilin e duhur dhe lëshon certifikata profesionale” zëvendësohen me fjalët “që ushtrojnë veprimtarinë e guidës turistike”.

Neni 14

Në nenin 45, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shkeljet e përcaktuara në nenet 30/1 e 30/2 të këtij ligji ndëshkohen me gjobë deri në 100 për qind të vlerës së investimit.”.

Neni 15

Në nenin 48, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Subjektet që kanë lidhur marrëveshje qiraje dhe zhvillimi me ministrinë përgjegjëse për turizmin, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar dhe nuk i kanë respektuar kushtet e marrëveshjeve dënohen nga Agjencia Kombëtare e Turizmit me gjobë në masën 100 për qind të detyrimit financiar që rrjedh nga moszbatimi i neneve respektive të marrëveshjes.”.

Neni 16

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 pika 1 e 5 pika 2 brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5786, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi